



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 16-2599/15
Kaçanik: 30.01.2015

Në bazë të nenit 12 të Rregullores 01Nr. 16-7909/2013 për Barazi Gjinore, në çështjen e shqyrtimit të Planit strategjik të veprimit të grupit joformal të grave, për vitin 2015, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.01.2015, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË VEPRIMIT TË GRUPIT
JOFORMAL TË GRAVE PËR VITIN 2015

I.

Me këtë Vendim, Apovohet Plani strategjik i veprimit të grupit joformal të grave, për vitin 2015.

II.

Në Planin e Grupit Joformal të grupit të grave për vitin 2015, janë paraqitur objektivat, lidhur me aktivitetet, akterët përgjegjës, treguesit e suksesit-rezultatet, afatet kohore, burimet e financimit dhe rreziqet.

III.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është: Plani i Veprimit të Grupit Joformal të grave për vitin 2015, i përmbledhur në gjithsej, 3 faqe.

IV.

Për realizimin e Planit strategjik të përcaktuar si në pikën I. të këtij Vendimi do të kujdesen: Grupi Joformal i Grave në Kaçanik.

V.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Grupi Joformal i Grave, Zyra për Barazi Gjinore dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

Plani strategjik i veprimtimit i grupit të grave për vitin 2015

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit- rezultatet	Afati kohor	Resurset- Burimet financiare	Rreziqet
Takime të rregullta të grupit të grave dhe ZBGJ para seancave të Kuvendit	Konsultime për çështjet që diskutohen në Kuvend në lidhje me çështjet gjinore. Takime sipas nevojës me përfaqësuesit e legjislativt dhe ekzekutivt.	G.G.A Z.B.GJ	Ngritja e çështjeve gjinore në kuvend.	Janar Dhjetor	Buxheti i Kuvendit Komunal 100 €	Mos interesimi i disa anëtareve në Kuvend mbi çështjet gjinore.
Ngritja e vetëdijes së barazisë gjinore në viset rurale	Ligjërata mbi buxhetimin e ndjeshëm gjinor (6 fshatra të Komunës së Kaçanikut) Ligjërata mbi të drejtat pronësore/trashëgimi në 4 fshatra Nxitje dhe mobilizim i femrave për pjesëmarrje në procesin e buxhetimit dhe planifikimit komunal	G.G.A Z.B.GJ OSBE	Përfitimi i njohurive në çështjen e barazisë gjinore nëpër vise rurale Ngritja e vetëdijes së femrave mbi çështjet trashëgimisë së pronës Ngritja e pjesëmarrjes së femrave në proceset e planifikimit buxhetor.	Janar Dhjetor	1500 €	Mos interesimi i femrave nga fshatrat për pjesëmarrje në ligjëratat e buxhetimit të ndjeshëm gjinor.



 Republika e Kosovës
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës
 Instituti i Kërkimit dhe Analizave
 Projekti i Përkrahjes së Qeverisë
 22.01.15
 Nr. 16-2589
 Vendi: FASHATAT
 Niveli: Shkollor
 Y.

Implementimi i Rregullores së re	Avokimi i GGA-së mbi çështjen e zbatimit të rregullores së miratuar për barazi gjinore	G.G.A Z.B.GJ	Ngritje të nivelit të përpjekjeve avokuese nga GGA-ja dhe Z.B.GJ.	Janar Dhjetor		Mos gatishmëria e antarëve të GGA-se dhe antarëve të Kuvendit në lidhje me zbatimin e rregullores
Trajnim dy ditor mbi buxhetimin e ndjeshëm gjinor dhe përfshirja e perspektivës gjinore në planifikimin e buxhetit komunal	Trajnim dy ditor për Drejtorët dhe anëtarët e GGA-se	G.G.A Z.B.GJ OSBE	Pjesëmarrja në hartim të planifikimit buxhetor Inicimi i një data-baze në lidhje me shpenzimet buxhetore sipas përqindjes së përfitimit të dy gjinive	Maj Shtator	800 €	Mungesa e kapaciteveve ekzistuese në lidhje me përpunimin e të dhënave
Një emision në radio mbi rëndësinë e barazisë gjinore	Emision në radio lokale mbi përfaqësimin gjinor, të drejtat e trashëgimise dhe barazisë gjinore Prezantimi i punës së GGA, qëllimi dhe fushëveprimi Njoftimi i grave të komunës në lidhje me vizitën e ekipit mobil të Mamografise nga Ministria e Shëndetësisë	G.G.A Z.B.GJ Radio lokale	Ngritja, sensibilizimi dhe vetëdijësimi i grave, meshkujve dhe shoqërisë civile në lidhje me barazinë gjinore, të drejtat e tyre në jetën shoqërore civile	Shtator Dhjetor	300 €	Mos funksionimi i radios lokale Mungesa e valëve të radios lokale në viset rurale

Shënimi i ditëve të caktuara Kombëtare dhe Ndërkombëtare	8 Marsi dita e Gruas 18 prilli dita kundër braktisjes së fëmijëve 25 Nëntori dita kundër eliminimit të dhunës ndaj gruas 10 Dhjetori, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut 3 Dhjetori, Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara	GGA Kuvendi Komunal Z.B.GJ MASHT OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Rritja e nivelit të zbatimit të ligjeve të aplikuara të cilat flasin për barazi gjinore . Vetëdijësimi i komunitetit nëpër vise rurale dhe urbane	Janar Dhjetor	1500 €	Mos gatishmëria e shoqërisë civile për pjesëmarrje Organizimi i aktiviteteve të njëjta nga shoqatat e ndryshme të fushës relevante
Aftësimi i GGA-së mbi menaxhimin dhe përpilimin e projekteve	Trajnim dyditor në aftësi themelore të menaxhimit të projektit. Përpilimi i një draft projekti për financim potencial	GGA-ja Z.B.GJ OSBE-ja	Ngritja e kapaciteteve ekzistuese të GGA-s mbi përpilimin e projekteve	Janar Shkurt	500 €	Mos gatishmëria e GGA-së për pjesëmarrje Mungesa e eksperteve për mbajtjen e trajnimit